

5.6 Termometri im i konfliktit

Qëllimi

N perceptojnë dhe e identifikojnë se për çfarë lloj konfliktesh ata janë veçanërisht të ndjeshëm. Krahasuar me të tjerët ata e kuptojnë se konfliktet përjetojnë dhe perceptohen subjektivisht. Kjo nuk ka të bëjë me atë se a është mirë apo keq, por se si dikush përjeton diçka.

kl. 4–9

30–45 min.



Materiali:
Kartat me të dhënat e temperaturës (0°, 50°, 100°), situatat për t'i lexuar (shih më poshtë).

Rrjedha:

- M shpjegon se për çfarë po bëhet fjalë (shih më lart) dhe i vendos të tri fletët e temperaturës në formën e një termometri në dysheme. 100° do të thotë se është një konflikt i nxehtë. 50° do të thotë se bëhet fjalë për një konflikt, por i cili ndoshta nuk është edhe aq i rëndësishëm. 0° simbolizon se situata në fjalë nuk përjetohet si konflikt.
- Pastaj M i lexon fletët me situatat e ndryshme konfliktuale. N e vendosin secilën herë në atë pozitë në termometër, e cila përputhet me vlerësimin subjektiv të ashpërsisë së konfliktit. Nëpërmjet deklaratave të shkurtra ata arsyetojnë se pse e kanë zgjedhur atë pozitë. Këto deklarata nuk duhet të komentohen; është fjala për paraqitjen e pikëpamjeve individuale se si e përjeton konfliktin secili/a.
- Në përfundim do të diskutohet dhe do të sqarohet nocioni «konflikt». Nëse është e mundshme, bëhet një përkufizim i përbashkët i nocionit dhe mbahet shënim për këtë.

Shtesë: Situatat për lexim para të tjerëve dhe fletët e temperaturave

Një nxënës ia vë stërkëmbësën nxënësit tjetër në oborrin e shkollës.	Një nxënës e fyen një nxënëse tjetër me fjalën «kurvë».
Një nxënës e kërcënon me rrahje nxënësin tjetër, sepse ai nuk ia jep atij xhaketën e vet.	Një shok të ka marrë hua të holla.
Një nxënëse bën një listë se cilët shokë/qe i do më shumë.	Një nxënëse i thotë një nxënësi «ty të vjen erë e keq»
Një nxënëse e merr celularin e shoqes së bankës, pa e pyetur atë dhe luan me të.	Një nxënës e rrëzon përtokë një nxënës tjetër, për të mënjeluar që ai të godasë një nxënës më të ri.
Ti dëshiron me qejf të luash një lojë. Por shoku yt më me dëshirë do të lexojë një libër.	Dy nxënës diskutojnë për një mësuese.

100°

50°

0°